



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 13 maj 2010
Nr. ref.: RMP 39/10

Vendim mbi Kërkesën për Masë të Përkohshme

në

Rastin nr. KI 02/10

Roland Bartetzko

kundër

**Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, S.C. AP-KZ 181/2002 të datës
12 nëntor 2002**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbëre nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Njëzëri miraton vendimin e mëposhtëm duke refuzuar kërkesën për masë të përkohshme, pa paragjykim në lidhje me ndonjë Vendimi përfundimtar për lejueshmërinë apo meritat e Kërkesës.

Parashtruesi

1. Parashtruesi është Z. Roland Bartetzko. Ai është shtetas gjerman. Ai është duke vuajtur dënimin në Burgun e Dubravës në afërsi Istogut, Kosovë. Ai përfaqësohet nga Dr. Kolë Krasniqi nga fshati Gllaviçicë, Pejë.

Vendimet e goditura

2. Gjykata Supreme e Kosovës, S.C. AP-KZ 181/2002, i datës 12 nëntor 2002.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon që të drejtat e tij, të garantuara me nenet 30 (të drejtat e të akuzuarit), 32 (e drejta për mjete juridike) dhe 102.5 (e drejta e ankesës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të drejtat e tij të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, janë shkelur. Ai pretendon që është deprimuar nga e drejta e tij themelore për ankesë, për shkak se avokati i tij mbrojtës gabimisht e ka njoftuar atë që ai nuk gëzon të drejtën për parashtruar ankesë ndaj dënimit të shqiptuar.
4. Ai kërkon nga Gjykata shqiptimin e masës së përkohshme për të rikthyer afatin ligjor të ankesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.Nr. 181-2002, që ka marrë formën e prerë gjashtë vite para se Kushtetuta e Kosovës të hynte në fuqi.

Baza ligjore

5. Neni 116 (2) i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Kushtetuta"), Neni 27 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji") dhe neni 52 (1) i i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Rregullorja e Punës").

Faktet

6. Më 10 maj 2002, Gjykata e Qarkut e Prishtinës shpalli Parashtruesin fajtor për, ndër të tjera, veprën penale të terrorizmit sipas Nenit 125 në ndërlidhje me Nenin 129 paragrafin 2 në ndërlidhje me paragrafin 1 (të ndryshuar më 16 qershor 1993, Gazeta Zyrtare e RFJ-së Nr. 37-193) të Kodit Penal të Jugosllavisë. Gjykata konstatoi që Parashtruesi më 18 prill 2001 ka vendosur materiale eksplozive para zyrave të Qendrës për Paqe dhe Tolerancë, ku punonin përfaqësuesit e ish Jugosllavisë. Shpërthimi shkaktoi vdekjen e një zyrtari të lartë të Qeverisë së Serbisë. Katër anëtarë tjerë të Qendrës u lënduan nga shpërthimi. Gjykata dënoi Z. Bartetzko me 23 vjet burg.
7. Më 12 nëntor 2002, Gjykata Supreme e Kosovës ndryshoi vendimin e Gjykatës së Qarkut. Gjykata Supreme pjesërisht miratoi ankesën e Parashtruesit dhe konfirmoi që ai është fajtor për veprën penale të terrorizmit sipas Nenit 125 në ndërlidhje me Nenin 139 paragrafi 2 të Kodit Penal të Jugosllavisë. Gjykata ndryshoi dënimin në 20 vjet burg, përfshirë kohën e kaluar në paraburgim nga 20 prill 2001 (S.C. Ap.Nr. 181-2002).
8. Sipas Parashtruesit, avokati i tij mbrojtës, Tomë Gashi, nuk ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe as që ka njoftuar atë për të drejtën e tij të ankesës. Në vend të kësaj, avokati mbrojtës i ka thënë Parashtruesit që ai nuk gëzon të drejtën e ankesës. Pasi që afati ligjor prej 15 ditësh për parashtrimin e ankesës skadoi, vendimi mori formën e prerë.
9. Më 31 dhjetor 2002, Parashtruesi pranoi një kopje të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

10. Pas kalimit të afatit ligjor, Z. Gashi kërkoi nga Gjykata Supreme ndryshimin e vendimit. Ai pretendonte që palët duhet të gëzojnë të drejtën e ankesës për shkak se vendimi nuk ka përmbajtur një mjet juridik. Më 8 qershor 2003, Gjykata Supreme njoftoi Parashtruesin që nuk mund të pranojë kërkesën e tij për shkak se ajo ishte parashtruar një vit e gjysmë më vonë pas ditës së pranimit të vendimit.
11. Më 15 qershor 2002, Parashtruesi i Kërkesës tërhoqi autorizimin për përfaqësim të Z. Gashi.
12. Më 8 gusht 2003, Parashtruesi kërkoi nëpërmjet avokatit të tij Z. Fazli Balaj që Gjykata e Qarkut e Prishtinës të rikthejë afatin ligjor për ankesë. Më 6 janar 2004, Gjykata e Qarkut e Prishtinës hodhi poshtë kërkesën e Parashtruesit për shkak se ajo ishte parashtruar pas periudhës ligjore të paraparë me paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 92 të Kodit Penal të Jugosllavisë.
13. Më 10 nëntor 2009, Prokurori i Shtetit i Kosovës njoftoi Parashtruesin që kërkesa e tij drejtuar Gjykatës Supreme është refuzuar për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Procedurat para Gjykatës Kushtetuese

14. Më 7 dhjetor 2009, Parashtruesi ka parashtruar Kërkesën e tij në Gjykatën Supreme. Më 5 janar 2010, Parashtruesi plotësoj Kërkesën me argumente tjera duke kërkuar nga Gjykata shqiptimin e masës së përkohshme për "rikthimin e afatit ligjor për ankesë."
15. Më 13 maj 2010, Paneli Shqyrtues ka shqyrtuar Raportin e Gjyqtarit Suroy dhe i ka rekomanduar Gjykatës, në përbërje të plotë, refuzimin e kërkesës për masë të përkohshme.

Ankesat e Parashtruesit

16. Parashtruesi ankohet që e drejta e tij për ankesë, e garantuar Nenin 102 të Kushtetutës dhe Nenin 394 (1) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, është shkelur. Sipas parashtruesit të kërkesës Neni 30 i Kushtetutës, që garanton të drejtat e të akuzuarit, po ashtu është shkelur.
17. Parashtruesi i Kërkesës pretendon që atij i është mohuar e drejta për të ushtruar këto të drejta themelore. Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 12 nëntor 2002, nuk përfshinte udhëzimin juridik për të drejtën e tij të ankesës dhe Kryetari i Trupit Gjykues nuk kishte ofruar udhëzime verbale. Për më shumë, avokati i tij mbrojtës i ka thënë atij që nuk gëzon të drejtën e ankesës. Vendimi i shqiptuar kundër tij ka marrë formën e prerë vetëm për shkak se (1) avokati i tij mbrojtës ka ofruar këshilla të gabuara dhe (2) ai nuk ka pasur njohuri të gjuhëve zyrtare për ligjet e zbatueshme në Kosovë. Për këto arsye, ai nuk ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtën e tij të ankesës.
18. Përfundimisht, Parashtruesi i Kërkesës pretendon që kjo shkel Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale dhe Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe po ashtu Kushtetutën e Kosovës, të drejtën e Unionit Evropian, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut. Në mënyrë që të korrigjohet kjo shkelje, afati ligjor i ankesës së tij do të duhej të rikthehej.

Vlerësimi i Kërkesës për Masë të Përkohshme

19. Parashtruesi i Kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë që do të arsyetonte shqiptimin e masës së përkohshme për rikthimin e afatit ligjor për ankesën e tij. Ai nuk ka dëshmuar që masa e përkohshme e propozuar është e nevojshme për të evituar rreziqe apo dëme të pariparueshme, ose që një masë e tillë është në interes publik, siç përcaktohet me Nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Si pasojë, kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit dhe Nenit 54(b) të Rregullores së Punës, në seancën e datës 13 maj 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. Të REFUZOJ kërkesën për masë të përkohshme.
- II. Sekretariati do të njoftojë Palët për Vendimin dhe do të shpall atë në Gazetën Zyrtare në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Altay Suroy, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.